

PLAN VEPRIMI
I
MINISTRISË SË MBROJTJES PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Në zbatim të objektivave kryesorë të Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Korrupsionit, Ministria e Mbrojtjes do të zbatojë këtë Plan Veprimi:

Nr.	Masa	Institucioni përgjegjës dhe institucioni bashkëpunues	Afati kohor	Burimet financiare	Treguesit e zbatimit
A. QASJA PARANDALUESE					
A.1	Rritja e transparencës dhe minimizimi i mundësive për korrupsion në FA				
A.1.1	Me qëllim eliminimin e praktikave korruptive në promovimin dhe arsimimin e personelit, Hartimi dhe miratimi në Parlament i paketës ligjore të FA: “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA” dhe ligjit “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të FA”	DPSHM; Drejtoritë në MM dhe SHPFA, Komandat e Forcave	shtator 2014	Nuk nevojiten shpenzime	Paketa e miratuar në Parlament në Shtator 2014. Ligji i Miratuar i Publikuar në QBZ.
A.1.2	Hartimi dhe miratimi në Parlament i ndryshimeve të ligjeve të FA: “Për statusin e ushtarakut të FARSH”.	DPSHM; Drejtoritë në MM dhe SHPFA, Komandat e Forcave	2014	Nuk nevojiten shpenzime	Paketa e miratuar në Parlament deri në fund të vitit 2014. Ligji i Miratuar i Publikuar në QBZ.
A.1.3	Rishikim i VKM 1403 “Për procedurat e blerjes nga MM të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik”	DPSNM; DPSHM	2014	Buxheti i MM	VKM e miratuar
A.1.4	Hartimi dhe miratimi i disa VKM për pagesën e ushtarakut, të kujdesit shëndetësor, të pagesës së papunësisë së bashkëshortit/es së ushtarakut etj	DPSHM; MM; SHPFA; Komandat e Forcave	2014	Nuk nevojiten shpenzime	Paketa e miratuar në Parlament brenda vitit 2014. Paketa e miratuar dhe Publikuar në QBZ.
A.1.5	Krijimi i strukturës së antikorrupsionit, dhe vënia në efijencë të plotë.	DPSHM DIP&A	prill 2014	Buxheti i MM	Koordinim i Luftës Antikorrupsion Brenda FA dhe me institucionet e tjera
A.1.6	Rishikim i politikave, procedurave dhe rregulloreve lidhur me arsimimin, emërimin, gradimin dhe dërgimin në misione jashtë vendit të ushtarakëve	MM, SHPFA, Komandat e Forcave	2014	Nuk nevojiten shpenzime	Dokumente të miratuara dhe në shërbim të personelit ushtarak e civil të FA
A.1.7	Hartimi i ndryshimeve të Ligjit 9707 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë” dhe akteve nënligjore për këto mallra	AKSHE, DPSHM, MM, SHPFA	2015	Nuk nevojiten shpenzime	Paketa e miratuar në Parlament Brenda vitit 2015. Paketa e miratuar dhe Publikuar në QBZ.
A.1.8	Aplikimi për marrjen e certifikatave të pronave në administrim të FA dhe miradministrimi i tyre	DPSHM, SHPFA, Komandat e Forcave	2014-2017	Buxheti i MM	Administrimi, privatizimi dhe kalimi tek pushteti vendor i pronave të tepërta të FA
A.1.9	Zbatim i rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me menaxhimin e personelit, pronave dhe gradimet	DPSHM, MM, SHPFA, Komandat e forcave	2014 -2017	nuk ka kosto	Rekomandimet të zbatuara

A.2	Rritja e aksesit të personelit dhe publikut në informacion				
A.2.1	Rritja e transparencës në menaxhimin e arsimimin e personelit, aseteve, burimeve financiare dhe publikimi në faqen zyrtare të MM	MM, SHPFA, Komandat e Forcave	2014 - 2017	buxheti i MM	Aksesim i personelit dhe publikut dhe bërja transparente e kurseve dhe gjithë veprimtarisë së MM dhe SHPFA
A.2.2	Rritja e aksesimit të personelit për të dhënat personale nga data-baze i personelit	MM, SHPFA, QPR	2014 - 2017	nuk nevojiten shpenzime	Aksesim i personelit dhe publikut dhe bërja transparente e veprimtarisë së MM dhe SHPFA
A.2.3	Ngritja dhe ofrimi i shërbimit arkivor online	MM, Dr. Arkivit dhe muzeut të FA	2016 - 2016	25.000.000 PBA	Marrja dhe ofrimi i shërbimit arkivor online
A.2.3	Rishikim i shërbimeve online që mund të ofrohen nga strukturat e MM	MM, SHPFA, QPR, Muzeu i FA	2014 - 2017	buxheti i MM	Aksesim i personelit dhe publikut për të marrë shërbimet online
A.3	Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve				
A.3.1	Ngritja dhe vënia në funksionim e Sistemit të Automatizimit të Shpenzimeve	Dr. Financës	2014 - 2017	16.000.000 lekë buxheti i MM	Transparencë dhe kontroll më i mirë për shpenzimet
A.3.2	Botim i dokumenteve për shpenzimet e mbrojtjes në kuadër të konventave të OKB dhe OSBE për armë-kontrollin	DPS	2014 - 2017	Nuk nevojiten shpenzime	Aksesim i organizmave ndërkombëtarë dhe publikut i shpenzimeve për këtë qëllim
A.3.3	Rritja e transparencës dhe publikimi i progr. të investimeve dhe buletineve të kontrollit financiar	MM, SHPFA, Komandat e Forcave	2014 - 2017	Nuk nevojiten shpenzime	Aksesim i personelit dhe publikut dhe bërja transparente e shpenzimeve dhe kontrollit të tyre
A.3.4	Zbatimi i rekomandimeve të KLSH lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin.	MM, SHPFA, Komandat e Forcave	2014 - 2017	Nuk nevojiten shpenzime	Rekomandime të zbatuara
A.4	Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të Forcave të Armatosura				
A.4.1	Mirëmbajtja dhe zhvillimi software i Sistemit të Integruar për Menaxhimin e Burimeve(SIMB)	DPSNM, DMBM, SHPFA, QPR, Komandat e Forcave	2015 -2017	215.500.000 lekë (57.500.000 lekë nga PBA i MM)	Implementimi i programit të menaxhimit të integruar. website i aksesueshëm
A.4.2	Ndërtim i rrjetit të klasifikuar	MM	2015	28.700.000 lekë	Implementim i rrjetit të mbrojtjes informacionit të klasifikuar.
A.4.3	Marrja dhe kthimi i përgjigjeve online të ankesave	DPSNM, Kabineti i Ministrit, DIP&A	2015	Buxh. MM, Sekt. kërkesë-ankesave	Aksesim online i publikut lidhur me kërkesë ankesat
A.5	Përmirësimi i sistemit dhe mekanizmave të trajtimit të ankesave				
A.5.1	Krijimi Sektorit të kërkesë ankesave në DIP&A	MM	2015	buxh MM (lëvizje të brendshme	Aksesim i publikut për kërkesat dhe ankesat
A.6	Krijimi dhe përdorimi i analizave të riskut				
A.6.1	Krijimi dhe përditësimi i regjistrit dhe analizat e riskut	MM, SHPFA, Kom. Forcave	2015	Buxheti i MM	Evidentim i riskut dhe marrja e masave parandaluese
A.7	Ruajtja e integritetit dhe shkallës së ndershmërisë së punonjësve				
A.7.1	Qarkullimi çdo tre vjet i punonjësve që administrojnë vlera materiale, personelit, prokurimeve dhe të policisë ushtarake	MM, SHPFA, Kom. Forcave	2014 - 2017	Buxheti i MM	Ruajtja dhe garantimi i integritetit të personelit.
A.8	Përmirësimi i statistikave nga institucionet ligjzbatuese dhe komandat				
A.8.1	Raportim i rasteve të korrupsionit dhe masave antikorrupsion	MM, Dr. Auditit, PU, AIM, Kom. Forcave	2014 - 2017	Buxheti i MM	Informim i publikut dhe personelit si dhe ndërgjegjësim i tyre për luftën kundër korrupsionit

B. QASJA NDËSHKIMORE					
B.2	Përmirësimi i bashkëpunimit për zbulimin dhe ndëshkrimin penal të korrupsionit				
B.2.1	Zbulimi, hartimi I praktikave dhe dërgimin në prokurori të rasteve të konstatuara të korrupsionit	MM, D. Auditit, DIP&A, PU, AIM.	2014 - vijon	Nuk ka kosto	Kallëzimet penale të dërguara në prokurori
B.2.2	Hartimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit mes AKSHE dhe AIM, QKR, QKL dhe FD me institucionet e tjera	AKSHE, DP Doganave P. Përgjithshme, QKR, QKL, AIM, FD, MPB.	2015	Nuk ka kosto financiare	Marrëveshjet e miratuara
B.2.3	Për forcimin e kompetencave të Policisë Ushtarake dhe parandalimin e fenomeneve korruptive, hartimi dhe miratimi i ligjit “Për Policinë Ushtarake në FA të RSH”	DPSHM, MM, SHPFA, PU	2014	Nuk nevojiten shpenzime	Ligji miratuar në Parlament deri në fund të vitit 2014. Ligji i miratuar i publikuar në QBZ.
B.2.4	Hartimi dhe miratimi në Parlament i ligjit “Për disiplinën ushtarake në FA të RSH”.	DPSHM, MM, SHPFA, Komandat	2014	Nuk nevojiten shpenzime	Ligji miratuar në Parlament (fund 2014). Ligji i miratuar i publikuar në QBZ
B.2.5	Hartimi dhe miratimi i një marrëveshje midis Policisë Ushtarake dhe prokurorisë për oficerët e Policisë Gjyqësore	DPSHM, MM, SHPFA, PU	qershor 2015	Nuk nevojiten shpenzime	Marrëveshja e miratuar
B.2.6	Seminare me oficerët e Policisë Gjyqësore të Policisë Ushtarake	Policia Ushtarake (PU)	qershor 2014	Nuk ka kosto	Listë-pjesëmarrja në trajnim, Axxhenda e trajnimit, Manualet e trajnimit
C. QASJA NDËRGJEGJËSUESE					
C.3	Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut në luftën kundër korrupsionit si dhe monitorimi i ecurisë në zbatimin e masave të marra nga Ministria e Mbrojtjes				
C.3.1	Marrja e shqetësimeve të personelit të FA dhe zgjidhjet e mundshme	MM, SHPFA, Komandat e Forcave	2014 - 2017	Nuk ka kosto	Urdhër i MM i miratuar
C.3.2	Krijimi i aksesit të personelit dhe publikut për denoncimin e rasteve korruptive në të gjitha format (elektronik, telefonik, letra etj.)	MM, SHPFA, Komandat e Forcave	2014 - 2017	Nuk ka kosto	Akses i vijueshëm, Ndjekja e denoncimeve